RAPORT NGA GARA SELEKSIONUESE PËR CONFFSPORT ITALIA

Data: 30 Prill dhe 01 Maj 2025
Vendi: Salla e Gjimnastikës, Pallati i Rinisë, Prishtinë
dhe salla e Klubit të Gjimnastikës Elita, Fushë Kosovë
Organizator: Federata e Gjimnastikës e Kosovës

Federata e Gjimnastikës së Kosovës organizoi një garë seleksionuese me qëllim përzgjedhjen e gjimnasteve për pjesëmarrje në garën ndërkombëtare Confsport Italia 2025. Gara u organizua për të përzgjedhur gjimnaste jashtë ekipit kryesor të përfaqësueses.

Njoftimi dhe pjesëmarrja

Me datë 23 Prill 2025, FGJK dërgoi njoftimin zyrtar për të gjitha klubet anëtare, duke u kërkuar që të propozojnë gjimnaste të mira jashtë ekipit kryesor. Afati për dërgimin e emrave ishte deri më 24 Prill 2025, ora 12:00.
Në total, në këtë garë morën pjesë 23 gjimnaste nga klube të ndryshme të Kosovës.

Detajet e organizimit

Gara u zhvillua në dy ditë dhe në dy lokacione të ndryshme:

Dita 1 (30 Prill 2025, ora 14:00) – Veglat: Parter dhe Paralele të shkallëzuara
Lokacioni: Salla e Gjimnastikës, Pallati i Rinisë

Dita 2 (01 Maj 2025, ora 10:00) – Veglat: Kapërcime dhe Tra
Lokacioni: Salla e klubit “Elita

Kriteret e vlerësimit

Në këtë garë seleksionuese, u aplikuan këto kritere:

Parter: Minimumi 6 elemente dhe prezencë e koreografisë me muzikë
Paralele të shkallëzuara: Minimumi 6 elemente

Tra: Minimumi 6 elemente
Kapërcime: Për grupmoshat e vogla: 2 tentime në dyshek (80–120 cm), vlerësohej mesatarja
Për grupmoshat tjera: 2 tentime në kaluç 1.25 m, vlerësohej mesatarja

Gjyqtarë në garë ishin: Doruntinë Ibrahimi, Abeliana Bregu, Ard Kryeziu dhe Arlind Shaqiri.

Rezultatet finale dhe përzgjedhja

Pas dy ditëve të vlerësimit, u përzgjodhën 10 gjimnastet me pikët më të larta për përfaqësimin e Kosovës në Confsport Italia 2025. Po ashtu, 7 gjimnaste tjera nga lista, jashtë top-10, u përzgjodhën për një garë ndërkombëtare në Maqedoninë e Veriut.

Lista e rezultateve finale:

Nr.	Emri	Pikët Finale
1	Jora Gërvalla	46.05
2	Tiara Dragusha	42.33
3	Elisa Bogaqku	42.12
4	Sumeja Hoxha	41.88
5	Elma Gashi	40.88
6	Troja Haradinaj	39.28
7	Olta Breznica	39.07
8	Rene Xhambazi	38.82
9	Vanesa Haziri	38.60
10	Flatra Peja	38.12
11	Duana Parduzi	35.90
12	Era Avdiu	35.47
13	Adea Shala	35.47
14	Lisa Ahmeti	34.15
15	Hana Rapucaj	33.65
16	Fiona Avdiu	32.87
17	Jara Gumnishta	30.17
18	Erona Zogaj	24.28
19	Anila Jashari	22.83
20	Fleta Kadrija	21.40
21	Ema Gojnovci	20.45
22	Jara Hasolli	10.03
23	Lorena Idrizi	8.80

Foto nga seleksionimi:









Amir Tahiraga: _____

Sekretar i Përgjithshëm i FGJK-së

FGJK – KGF

Shtëpia e Sporteve, Rr: "Agim Ramadani" 10000 Prishtine, tel: +38344145009, email: kosovagymnasticsfederation@gmail.com